VENDIM
Nr. 207, datë 11.12.2020

MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE, NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT, PËR MUAJIN NËNTOR 2020

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të "Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar; të nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 3.9.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 11.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur me nr. 131/5 prot., datë 9.12.2020, nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, "Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit" për muajin nëntor 2020,

konstatoi se:

- Shoqëria FSHU sh.a. me shkresën e saj nr. 10979 prot., datë 2.12.2020, ka paraqitur në ERE aplikimin për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike, për muajin nëntor 2020, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.
- FTL sh.a. ka realizuar katër procedura për blerje të energjisë elektrike, respektivisht për plotësimin e nevojave të "Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes" sh.a. dhe "Furnizuesit të Shërbimit Universal" sh.a.
- Bazuar në kërkesën e shoqërisë FSHU sh.a., kostot administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit për vitin 2020, janë vlerësuar sa ato të vitit 2019.
- Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit, bazuar në vendimin nr. 198, datë 12.12.2019, "Mbi lënien në fuqi të vendimit nr. 266, datë 21.12.2018, të Bordit të ERE-s, në lidhje me tarifën e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2020", është 0.75 lekë/kwh.
- Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 35 kV, bazuar në vendimin nr. 199, datë 12.12.2019, të Bordit të ERE-s, "Mbi shtyrjen e fuqisë juridike të vendimit të ERE-s nr. 268, datë 21.12.2018, për tarifat e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes, sipas nivelit të tensionit, për vitin 2020", është 1.5 lekë/kwh.
- Në zbatim të "Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit" të rishikuar, llogaritjet e FSHU sh.a., si dhe përllogaritjet e ERE-s për përcaktimin e çmimit për klientët që furnizohen nga FMF-ja, për muajin nëntor 2020, paraqiten në tabelën përmbledhëse si vijon:

Çmimi i FMF-së për muajin Nentor 2020

	Nentor 2020	Njësia	Aplikimi FSHU sh.a. Çmimi	Përllogaritjet e ERE Çmimi
CBEt	Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes në treg të paregulluar ose blerja nga prodhuesit me përparësi	Leke/kWh	7.072	7.072
Pr	Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	Leke/kWh	0.21	0.21
	Çmimi mesatar i blerjes ne periudhen relevante	Leke/kWh	7.28	7.28
CA	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Leke/kWh	1.79	1.79
TRr	Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Leke/kWh	0.75	0.75
TSHt	Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Leke/kWh	1.50	1.50
	Çmimi i energjisë = CBEt +Pr* CBEt+ TRrTSHt+CA	**Leke/kWh**	**11.32**	**11.32**

- Për sa përcaktuar, për çdo element të formulës përllogaritëse, bazuar në informacionet e paraqitura në këtë aplikim, informacionit të përcjellë nga FTL sh.a., si dhe vlerësimeve të ERE-s sa më sipër, rezulton se çmimi i shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin nëntor 2020, të jetë 11.32 lekë/kwh.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike, të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, prej 11.32 lekë/kwh, për muajin nëntor 2020.

2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti